



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

---

## **STRATEGJIA DHE PLANI ZHVILLIMOR I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT**

**2017-2019**

Prishtinë, dhjetor 2016

## **Përmbajtja**

<b>HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>MANDATI DHE ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT .....</b>	<b>4</b>
<b>VIZIONI .....</b>	<b>6</b>
<b>MISIONI .....</b>	<b>6</b>
<b>QËLLIMI .....</b>	<b>6</b>
<b>OBJEKTIVAT STRATEGJIKE .....</b>	<b>6</b>
<b>ZBATIMI DHE MATJA .....</b>	<b>12</b>
<b>RREZIKU .....</b>	<b>12</b>

## HYRJE

Institucioni i Avokatit të Popullit ka kënaqësinë që të prezantojë dokumentin e parë strategjik, i cili do të shërbejë si udhërrëfyes i punës sonë për tri vitet e ardhshme 2017-2019. Si i vetmi institucion kombëtar i pavarur për të drejtat e njeriut, i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i cili është mbrojtës dhe garantues thelbësor për realizimin e mbikëqyrjes, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Republikën e Kosovës.


Kjo strategji bazohet në vizionin, misionin dhe parimet e përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit<sup>1</sup> dhe në pajtueshmëri me Parimet e Parisit,<sup>2</sup> të cilat shërbejnë si bazament i funksionimit të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe janë kritere minimale që institucione të tilla duhet të kenë që të konsiderohen kredibile në arenën ndërkombëtare.

Qëllimet tona janë të qarta, ne do të sigurohemi që në shoqërinë tonë të ngritet besueshmëria dhe ndërgjegjësimi mbi rolin e Avokatit të Popullit, të drejtat e njeriut dhe mekanizmat e tyre të mbrojtjes. Prandaj, kjo strategji është produkt i hartuar sipas kontributit të dalë nga një konsultim i gjerë me të gjitha departamentet e institucionit për rrethanat aktuale dhe si e tillë paraqet rrugën e domosdoshme që duhet të kalohet sipas një planifikimi të saktë afatmesëm. Me anë të saj, ne do të jemi në gjendje jo vetëm të vlerësojmë dhe matim ndikimin e punës sonë, por gjithashtu do të jetë indikator i fuqishëm për përmirësimin edhe më të madh të performancës sonë në të ardhmen.

Në këtë strategji janë definuar qartë objektivat dhe prioritetet që duhet të arrihen me qëllimin e përmirësimit të situatës së të drejtave dhe lirive të njeriut përmes punës së Institucionit të Avokatit të Popullit. Ne jemi të vetëdijshëm që zbatimi i këtyre objektivave nuk do të jetë i lehtë, sidomos pas shtimit të mandateve nga pakoja ligjore për të drejtat e njeriut, meqë institucioni në vazhdimësi është përballur me burime të limituara njerëzore dhe financiare, mirëpo jemi të sigurt që ne do të mund të mbështetemi pjesërisht edhe në ndihmën e partnerëve tanë ndërkombëtarë, për ta zbatuar edhe këtë strategji.

Në fund, dëshiroj të theksoj që ne do të mbesim të përkushtuar që aktivitetet e parapara në strategji të realizohen në praktikë dhe përmes tyre, në njërën anë, të arrijmë synimet tona për mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe në anën tjetër, të sfidojmë keqeverisjen, diskriminimin dhe pabarazisë. Jemi të bindur që përkushtimi i pakursyer ndaj punës do të prodhojë rezultatet e pritura.

Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit



<sup>1</sup> Ligji për Avokatin e Popullit: [http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/LIGJI\\_NR.\\_05\\_L-019\\_P%C3%8BR\\_AVOKATIN\\_E\\_POPULLIT\\_276695.pdf](http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/LIGJI_NR._05_L-019_P%C3%8BR_AVOKATIN_E_POPULLIT_276695.pdf)

<sup>2</sup> Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme për Parimet e Parisit për funksionimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, Nr: 48/134



## **I. MANDATI DHE ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT**

Zyra e Avokatit të Popullit është themeluar për herë të parë në vitin 2000. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në Kapitullin e XII të saj, përcakton rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit në Kosovë, po ashtu, Ligji për Avokatin e Popullit, Nr.05/L-019, rregullon organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), përgjegjësitë dhe mënyrën e punës së IAP-së, si dhe procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre.

IAP paraqet mekanizmin ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si dhe vepron si Mekanizëm Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjithashtu, Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, të cilat ligje, bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit përbëjnë pakon ligjore të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga organet, institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Si institucion i pavarur, udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Me qëllim të identifikimit të problemeve dhe me qëllim të sigurimit të të dhënave për shkeljet e supozuara, Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e Popullit detyron çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, t'i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqes atij të gjitha dokumentet dhe të dhënat e kërkuara.

Avokati i Popullit zhvillon hetime, jep rekomandime, publikon raporte, si dhe avokon për të drejtat dhe liritë e njeriut. Në rastet kur hetimet e këshilltarëve ligjorë të IAP-së rezultojnë me gjetje të shkeljeve të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit mund të kërkojë njoftime plotësuese nga autoritetet publike dhe të bëjë rekomandime për autoritetet përgjegjëse përkatëse. Në rastet kur Avokati i Popullit konsideron se një praktikë ose situatë e përgjithshme nuk është në pajtim me standardet vendore a ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndikon te një individ apo më gjerë, atëherë bën raporte speciale, të cilat përfshijnë edhe rekomandime të drejtuara Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve tjera relevante, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së krijuar dhe të harmonizimit të saj me standardet vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.



Avokati i Popullit, avokimin dhe ndikimin për avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, mund ta bëjë edhe nëpërmjet mediave.

IAP ka mundësi të hapë hetime Ex Officio ( pa ankesë individuale) për dyshimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Po ashtu, ka për mision t'i vëzhgojë politikatat dhe ligjet e miratuara nga autoritetet vendore, për të siguruar që ato të jenë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut dhe me kërkesat e qeverisjes së mirë.

IAP merret me hetime lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve, por nuk e zëvendëson gjykatën dhe nuk mund t'i hetojë krimet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo t'i ndryshojë vendimet e gjykatës ose të japë vendime detyruese.

Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Po ashtu, Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit. Mirëpo, nuk merret me hetimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me kontestet që zhvillohen ndërmjet personave privat. Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.

IAP mund të ofrojë shërbime edhe për ankesa të qytetarëve të saj, që drejtohen kundër autoriteteve publike jashtë Kosovës, dhe t'i përcjellë ato tek institucioni relevant (në shumicën e rasteve tek institucionet homologe – Ombudsman), në vendin tjetër, ose tek ndonjë institucion tjetër homolog.

Sfidë dhe objektiv kryesor i IAP-së mbeten krijimi dhe zhvillimi i asaj, që quhet kulturë e qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të autoriteteve publike para qytetarëve të Kosovës, si dhe forcim të përgjithshëm të sundimit të ligjit. Angazhimi i IAP-së për balancim të raporteve në mes administratës publike dhe qytetarëve, të cilëve kjo administratë mëton t'u shërbejë, ka po këtë qëllim. Rekomandimet e Avokatit të Popullit synojnë të sjellin përmirësime në standardet dhe në cilësinë e shërbimeve të autoriteteve publike ndaj qytetarëve.

Synim i veprimtarisë efikase të Avokatit të Popullit është shtimi i besimit të njerëzve tek institucioni dhe administrata, duke siguruar relacion koherent ndërmjet qytetarit dhe administratës publike. Kjo është e domosdoshme për funksionimin e demokracisë. Për këtë arsye Avokati i Popullit është pjesë e atyre institucioneve që konsiderohen si gardian të demokracisë, të shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut.

Ankesat e personave juridikë dhe fizikë mund të drejtohen në IAP, sipas një procedure të thjeshtë dhe pa pagesë. Pranimi i ankesave bëhet në Zyrën Qendrore dhe zyrat rajonale të IAP-së. Këto ankesa mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të autoriteteve publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve përkatës kanë të bëjnë me dhënien e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave dhe informatave nga autoritetet publike përkatëse, nga gjykatat dhe nga institucionet e tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara gjyqësore. Në rastet që kërkojnë



veprime të menjëhershme, IAP paraqet kërkesë për masë të përkohshme. Lidhur me këtë, mënyra e veprimit ndryshon, varësisht nga natyra e rasteve individuale.

## **II. VIZIONI**

Vizioni i Institucionit të Avokatit të Popullit është krijimi i një mjedisi të favorshëm për zbatim efektiv të të drejtave dhe lirive të njeriut në pajtim me standardet ndërkombëtare, duke qenë forcë shtytëse për t'i vënë qytetarët në qendër të kulturës administrative në Republikën e Kosovës.

## **III. MISIONI**

Misioni i IAP-së, si mekanizëm ligjor, është mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës nëpërmjet: pranimit dhe hetimit të ankesave për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga autoritetet publike në Kosovë, parandalimi i torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, mbrojtja nga diskriminimi dhe barazia gjinore, për t'i kontribuar qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies së administratës publike para qytetarëve të Kosovës dhe forcimit të sundimit të ligjit në epiqendër të së cilit qëndrojnë mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut në Kosovë.

## **IV. QËLLIMI**

Qëllimi themelor i Institucionit të Avokatit të Popullit është zbatimi i standardeve për të drejtat dhe liritë e njeriut, përmes ngritjes së përgjegjshmërisë të autoriteteve publike, mbikëqyrjes së shkeljeve sistematike dhe rivendosjes të së drejtës duke forcuar kulturën e llogaridhënies dhe miradministrimit.

Në përputhje me rolin e Avokatit të Popullit, kemi për qëllim që të arrijmë pozitë të rëndësishme në shoqërinë tonë dhe tek autoritetet publike, të sigurojmë vëmendjen e publikut tek Avokati i Popullit, si dhe të kemi ndikim të vërtetë dhe pozitiv në administratën publike.

Gjithashtu, nëpërmjet kësaj strategjie synohet të sigurohet një kornizë shumëvjeçare mbi përdorimin ekonomik, efikas dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare të mbështetura në buxhetin e IAP-së, dhe përbën një pikë referimi për akterët e jashtëm për të vlerësuar performancën dhe llogaridhënien.

## **V. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

Strategjia 2017-2019 është dokument bazë për planifikimin vjetor të punës dhe aktiviteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjithashtu, ky dokument ka për qëllim të shërbejë si udhëzues përgjatë tri viteve në promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, po ashtu në pajtim të plotë me vizionin e Avokatit të Popullit.

Kjo strategji do t'i shërbejë objektivave si në vijim:

1. Ngritja e besueshmërisë së qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
2. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, me fokus të veçantë në çështjet sistematike të cilat janë më të rëndësishme për interesin dhe shqetësimet e qytetarëve;
3. Ngritja e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit;
4. Fuqizimi i kapaciteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim të rritjes së ndikimit dhe efektivitetit në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

### **1. Ngritja e besueshmërisë së qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore**

Realizimi i këtij objekti bazohet në një nga shtyllat e misionit kushtetues dhe ligjor të Institucionit të Avokatit të Popullit për promovimin e të drejtave të njeriut, përmes vetëdijesimit dhe informimit të publikut me anë të mediave dhe komunikimit të drejtpërdrejtë, si dhe transparencës së aktiviteteve dhe punës së IAP-së, si një nga format e llogaridhënies përpara qytetarëve, me anë të të cilave ngritet edhe besueshmëria e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në Institucionin e Avokatit të Popullit, pa dallime, duke përfshirë edhe pakicat.

#### Prioritetet e Avokatit të Popullit:

- 1.1 Vetëdijesimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, promovimi i mandatit dhe edukimi për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend;
- 1.2 Fuqizimi i imazhit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe maksimizimi i ndikimit të tij;
- 1.3 Forcimi i rolit të IAP-së në promovimin e transparencës, llogaridhënies, integritetit dhe njohjen e tij si institucion që ushtron mandatin e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale;
- 1.4 Rrjetëzimi dhe promovimi i aktiviteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit përmes komunikimit institucional në nivel vendi;
- 1.5 Fuqizimi i bashkëpunimit me mediat dhe shoqërinë civile;
- 1.6 Sfidimi publik i diskriminimit dhe pabarazisë.



## **2. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, me fokus të veçantë në çështjet sistematike të cilat janë më të rëndësishme për interesin dhe shqetësimet e qytetarëve**

Roli i Avokatit të Popullit, tashmë është dëshmuar të jetë shumë domethënës në ndërtimin e demokracisë dhe të miradministrimit. Kjo për arsye të dedikimit të demokracive të reja për të arritur standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në njërin anë, dhe ballafaqimit me sfidat e së kaluarës lidhur me kulturën e respektimit të drejtave të njeriut në anën tjetër.

Duke konsideruar se gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit nëpërmjet hetimit të rasteve me iniciativën e vetë (ex officio), sidomos në problemet sistematike mbi shkeljet e të drejtave të njeriut, ka pasur ndikim të madh dhe pozitiv në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe të cilat kanë përfshirë numër të konsiderueshëm të qytetarëve. Gjithashtu, kishte një ndikim pozitiv tek autoritetet përgjegjëse, të përfshira në këto probleme. Prandaj, Avokati i Popullit, do të përdorë kompetencat e tij dhe do të vazhdojë të fokusohet në identifikimin dhe hetimin e problemeve sistematike me qëllim të ndikimit në ndërtimin e demokracisë dhe të miradministrimit duke mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

### Prioritetet e Avokatit të Popullit:

- 2.1 Fokusim në shkeljet e mundshme sistematike të të drejtave dhe lirive të njeriut nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe të rregullt të mediave dhe informacioneve tjera publike, apo ankesave të parashtruara të cilat reflektojnë shkeljet sistematike me qëllim të identifikimit të fushave të keqadministrimit nga institucionet publike dhe mundësitë e përmirësimit të tyre me përdorimin e mekanizmave të Avokatit të Popullit duke hapur hetime me vetë iniciativë.<sup>3</sup>
- 2.2 Bashkëpunimi me grupet e interesit të sektorit joqeveritar, me qëllim të shfrytëzimit të kapaciteteve të përbashkëta në hetimin e rasteve të shkeljeve sistematike dhe ofrimin e këshillave, opinioneve dhe rekomandimeve për avancimin e të drejtave dhe lirive.
- 2.3 Të sigurojë mbikëqyrje lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të nxisë institucionet përgjegjëse publike për harmonizimin e të gjitha ligjeve, udhëzimeve administrative, politikave dhe programeve me standardet e të drejtave të njeriut duke rekomanduar edhe hartimin e ligjeve të reja me qëllim të ofrimit të një mbrojtje të përshtatshme për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

---

<sup>3</sup> Kërkesat për Masë të Përkohshme; Amicus Curiae; Opinionet, Raportet e veçanta ose speciale dhe rekomandimet



2.4 Bashkëpunimi me kryetarët e gjykatave të rregullta lidhur me identifikimin e çështjeve sistematike të parashtruara para gjykatave dhe shfrytëzimi i këtyre informatave për të vepruar sipas mandatit *amicus curiae*.<sup>4</sup>

### **3. Ngritja e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit**

Pas përfundimit të hetimeve, nëse Avokati i Popullit konstaton se autoritetet publike kanë bërë shkelje, harton raport i cili përmban rekomandime për autoritetet përgjegjëse për të vënë në vend të drejtën e shkelur. Me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nëpërmjet të cilave kontribuohet në qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve, Avokati i Popullit do të angazhohet për:

3.1 Krijimin e një sistemi të brendshëm të mbikëqyrjes së rekomandimeve të miratuara nga Avokati i Popullit nëpërmjet shfrytëzimit të bazës elektronike të të dhënave për të identifikuar institucione përgjegjëse publike të cilat kanë dështuar të zbatojnë rekomandimet e adresuara. Kjo me qëllim të përdorimit të mekanizmave shtesë të Avokatit të Popullit për të përmbushur rekomandimet e dhëna.<sup>5</sup>

3.2 Fuqizimin e bashkëpunimit me Komisionin funksional të Kuvendit për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, përmes takimeve të rregullta, raportimeve dhe njoftimeve në lidhje me zbatueshmërinë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit

3.3 Intensifikimin e bashkëpunimit dhe dialogut me institucionet e pushtetit qendror, lokal dhe palët tjera të interesit për të mbështetur vetëdijesimin lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

3.4 Bërja publike e konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbi dështimin e autoriteteve publike për të zbatuar rekomandimet brenda afateve të përcaktuara nga Avokati i Popullit përbën bazë të mjaftueshme për të ngritur llogaridhënien e institucioneve përgjegjëse.<sup>6</sup>

### **4. Fuqizimi i kapaciteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim të rritjes së ndikimit dhe efektivitetit në mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore**

Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm i vetëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është i themeluar me Kushtetutë. Miratimi i pakos ligjore për të drejtat e njeriut, Ligji për Avokatin e Popullit 05/L-019, për Barazi Gjinore 05/L-020 dhe Mbrojtje nga Diskriminimi 05/L-021, kanë përcaktuar kompetenca shtesë dhe institute të reja juridike, për të cilat është autorizuar Avokati i Popullit (*Amicus Curiae*, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të

<sup>4</sup> Neni 16, paragrafi 9 i Ligjit për Avokatin e Popullit dhe neni 9, paragrafi 2.13 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

<sup>5</sup> Raporti vjetor ; Komisioni ndërministrorë për të drejtat e njeriut; Harmonizimi i të dhënave me të dhënat e Zyrës për Qeverisje të Mirë në ZKM; Neni 24 paragrafi 4 dhe neni 25 paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit për Avokatin e Popullit.

torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, kompetencat në hetimin e rasteve të diskriminimit në sektorin privat). Këta faktorë juridikë implikojnë domosdoshmërinë e ngritjes së kapaciteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit për zbatim të përshtatshëm të mandateve të lartëcekura.

Gjithashtu, ndikimi i ligjeve të reja shtron si nevojë edhe përshtatjen e strukturës së brendshme organizative të Institucionit të Avokatit të Popullit në pajtim me rregulloren tashmë të miratuar për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës Nr. 01/2016 dhe Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit Nr. 02/2016. Për më tepër vendimi i Gjykatës Kushtetuese KO 73/16, i datës 8 dhjetor 2016 përbën argument shtesë për një qasje të pavarur organizative, funksionale dhe buxhetore të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të institucionit dhe sigurimin e procesit të ngritjes së kapaciteteve në aspektin praktik/pragmatik, është e rekomanduar që të organizohen vizita studimore në institucionet kombëtare të specializuara në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe për t'iu qasur aspekteve praktike, por, edhe për të intensifikuar ndër- bashkëpunimin institucional. Në këtë drejtim edhe Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi i jep kompetencë IAP-së, që të hartojë Kode të Praktikave të Mira për luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë, të cilat, mund të përdoren si një pikë referimi në rastet e diskriminimit.

Zbatimi i mandateve dhe strukturës organizative përbëjnë bazën e nevojës për ngritjen e kapaciteteve e të dy sektorëve brenda Institucionit të Avokatit të Popullit (Departamenteve juridike dhe atij Administrativ), sipas prioriteteve si në vijim:

4.1 Fuqizimin e rolit dhe kapaciteteve të IAP-së për zbatim efektiv të mandatit të Avokatit të Popullit, të bazuar në Kushtetutën e Republikës të Kosovës, Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e të tjera. Ngritja profesionale përmes trajnimeve të avancuara dhe vizitave studimore për secilin sektor, veçmas për çështjet e Amicus Curaie, të MKPT, për diskriminimin në sektorin privat, etj;

4.2 Në mënyrë të vazhdueshme të zhvillohen aftësitë dhe kapacitetet profesionale të stafit të IAP-së, në mënyrë që të adresohen rekomandime të qarta, mirë të argumentuara, me dëshmi relevante duke u ndihmuar lexuesve të kuptojnë arsyen pse Avokati i Popullit i bën këto rekomandime dhe për të qenë bindës për autoritetet se duhet zbatuar rekomandimet.

4.3 Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimi i praktikave më të mira për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

---

<sup>6</sup> Strategjia e Avokatit të Popullit për Marrëdhënie me Publikun dhe Mediat 2016-2018 (kumtesat në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve)



- 4.4 Trajnime për stafin menaxherial për planifikimin e punës, kontrollë, raportim dhe matjen e performancës me qëllim të organizimit, koordinimit dhe funksionalizimit të punës të sektorëve individualisht dhe si një tërësi për IAP-në, me rastin e ushtrimit të mandatit, të detyrave të punës dhe të menaxhimit të resurseve njerzore dhe materiale nga ana e tyre.
- 4.5 Trajnime të stafit menaxherial (duke mos përjashtuar edhe këshilltarët ligjor) të shërbimit profesional për prezantime autoriteteve dhe komunikim të artikuluar, me qëllim të përfaqësimit/prezantimit të punës/mandatit të IAP nëpër medime, tryeza/konferenca, tek autoritetet publike, jashtë vendit, etj. Fokus i këtyre trajnimeve do të jetë avancimi i teknikave të komunikimit gojor dhe në të shkruar për, prezantime dhe përfaqësime institucionit.
- 4.6 Trajnime të ndryshme për të gjithë stafin e IAP në çështjet e komunikimit organizativ, punës në ekip/grupe dhe ndërtimit të ekipit/grupit, komunikimit ndër-personal, menaxhimit të konflikteve dhe ndërmjetësimit, zgjidhjes së problemeve, menaxhimit të kohës.
- 4.7 Trajnim të stafit të IAP-së në çështjet më të rëndësishme për punën e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, njohuritë për të cilat është e nevojshme që të ripërtrihen dhe të përsëritën në vazhdimësi, në mënyrë që përformimi i detyrave të stafit të jetë në pajtueshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare, si:
- Legjislacionin kombëtar për të drejtat e njeriut, veçanërisht ato të parashikuara në Ligjin e Avokatit të Popullit, si dhe në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligjin për barazinë gjinore;
  - Interpretimi i të drejtave të njeriut, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjatë trajtimit të rasteve në IAP (neni 53 i Kushtetutës);
  - Standardet ndërkombëtare, dokumentet dhe mekanizmat për të drejtat e njeriut, përfshirë Mekanizmin për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të tjera Muzore, Jonjerëzore dhe Degraduese;
  - Rolin e Amicus Curiae;
  - Promovimin e të drejtave të njeriut
  - Arsytimin ligjor dhe aftësitë e të shkruarit;

Për më tepër, aspekti praktik i Programit të Trajnimit duhet të sigurohet duke përdorur teknika të ndryshme, moderne interaktive të trajnimit dhe metoda të adaptuara të natyrës specifike të aftësisimit për të rritur, si dhe përmbajtjen dhe veçoritë e veprimtarive profesionale të pjesëmarrësve (në hetimin e rasteve të vërteta).

## **VI. ZBATIMI DHE MATJA**

Në mënyrë që të arrihen objektivat e mësipërme, duhet të ndërmerren veprime konkrete, të planifikohen dhe vlerësohen prioritetet në baza vjetore dhe me anë të proceseve.

Me qëllim të planifikimit, monitorimit dhe zbatimit sa më të saktë të strategjisë dhe që ne të mund të masim progresin tonë në arritjen e objektivave dhe prioritetëve, do të hartohet Plani i Veprimit, Plani Strategjik i Menaxhimit të Rrezikut si dhe Plani Strategjik i Trajnimeve, që në fund të çdo viti kalendarik këto dokumente do të rishikohen.

Me vendim të Avokatit të Popullit do të caktohet Grupi i Punës për zbatimin e strategjisë, si dhe Grupi i Punës për hartimin e dokumenteve të lartpërmendura, që gjithashtu, ky grup mund të mbështetet nga asistenca e jashtme.

Dokumentet e lartpërmendura mbi zbatimin dhe matjen e prioritetëve, që të arrihen objektivat e përcaktuara në strategji, duhet të miratohen nga Avokati i Popullit.

## **VII. RREZIKU**

Pjesë e rëndësishme e planit strategjik është që në mënyrë aktive të identifikojë dhe menaxhojë rrezikun. Kjo do të bëhet duke identifikuar rreziqet strategjike dhe operacionale, duke vlerësuar mundësinë dhe ndikimin e tyre për të përcaktuar se si ato duhet të menaxhohen në mënyrë aktive, në përputhje me buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Për këtë qëllim do të hartohet Plani Strategjik i Menagjimit të Rrezikut.

Rreziqet do të menaxhohen dhe do të rishikohen rregullisht në bazë të Planit Strategjik të Menaxhimit të Rrezikut nga ana e Grupit për Vlerësim dhe Monitorim të Performancës së Menaxhimit të Rrezikut, i cili do të formohet me vendim nga Avokati i Popullit.